



DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

05 NR.755

Datë 17.08.2018

Bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032 si dhe në Udhëzimin Administrativ Nr.22/2013 Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, Drejtoria komunale e Arsimit shpall

KONKURS PLOTËSUES
PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) TË GJIMNAZEVE DHE TË
SHKOLLAVE PROFESIONALE PËR VITIN SHKOLLOR 2018/2019

1.Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2018/19, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9 të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2.Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe shkolla profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)

Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe

Ekstraktin e lindjes.

3.Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe shkolla profesionale për vitin shkollor 2018/2019, bëhet më datën 20, 22,23 gusht 2018 në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën 24.08.2018.

Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej 27.06.2018.

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHT - komisionit për ankesa.

A.Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

- | | |
|---|----------------------|
| 1. Suksesi nga shkollimi i obliguar | (25%) 25 pikë |
| 2. Suksesi nga lëndët prioritare në test | (15%) 15 pikë |
| 3. Numri i pikëve nga testi | (60%) 60 pikë |

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë **100** pikë.

Gjimnazi “ Jeta e re”- Suharekë

Nr.	Profili	Vende të lira
1	Shkenca shoqërore	19

Shkolla e mesme teknike”Skender Luarasi”- Suharekë

Nr.	Profili	Vende të lira
1	Informatikë	28
2	Instalues elektrik	7
3	Automekanik	8
4	Mekanik i makinave	11
5	Ndertimtari	19
6	Gjeodezi	19
7	Arkitekturë	12

Shkolla profesionale „Abdyl Ramaj”- Shirokë

Nr	Profili	Vende të lira
1	Asistent administrate	2
2	Tregtar me shumice dhe pakice	3
3	Laborant i kimisë	4
	Teknologjia e materialit të ndërtimit	6
	Teknologjia e riciklimit	6
	Teknologjia e prodhimit të këpucëve dhe galanterisë	28
4	Pemtari-vreshtari	4
	Teknologjia ushqimore	5
5	Asistent restorani	28
	Asistent turisti	5
6	Perpunim i drurit	16
		336

DREJTORIA E ARSIMIT-SUHAREKË

